



Kuvendi i Komunës, Klinë

Nr prot. *06-1735/2024*

Datë: *05.06/2024*

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40, paragrafi 40.2 shkronjën h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenin 40 pikën 11 të Statutit të Komunës së Klinës i miratuar në Mars 2010, Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale si dhe procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera. Me propozimin e Komisionit të themeluar nga Kuvendi. Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2024 të mbajtur me 30.05.2024, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Komisionit të themeluar nga Kuvendi për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për veprimtarin e çështjes kombëtare profesor Ymer Berisha.
2. Ndarja e titullit si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet në shenjë nderimi për veprën e tij të jashtëzakonshme atdhetare e politike për historinë dhe të ardhmen e Kosovës si dhe mbar interesave nacionale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkpunim me Drejtorin për Kultur, Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi